



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT  
MUNICIPALITY OF DEÇAN  
OPSTINA DEÇAN



Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër

12 Nr. \_\_\_\_\_ /2023

Dt. 20 / 01 /2023

## Raporti i Punës - 2022

Drejtorin për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë brenda vitit 2022 shqyrton mbi 4000 mijë landë te natyrave të ndryshme

Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë në komunën e Deçanit brenda vitit 2022, ka shqyrtuar **4483** kërkesa të natyrave të ndryshme, këtë e bëri të ditur Drejtori i këtij dikasteri z.Agron Muslijaj .

Muslijaj tregon se si drejtori ne vazhdojmë të jemi të koordinuar mjaftë mirë që në afat kohorë të përfundojmë të gjitha lëndët të cilat vijën si kërkesë e qytetarëve të komunës së Deçanit e ne si dikaster jemi te ngarkuar me punë shumë përgjithësi.

Të përfundohen të gjitha këto kërkesa do të thotë se duhet të jesh i gatshëm të përballesh më specifika e secilës kërkesë veç e veç duke ju përshtatur edhe aftit kohorë por falë gatishmërisë së kësaj drejtoirie në kemi arrite që më përpikëri të kryem detyrat tona karshi qytetarëve, varësisht nga kërkesa si është parashtruar e gjithmonë duke i përfillur edhe afatet ligjore .

Lëndët të cilat janë shqyrtuar në vitin 2022 janë:

Zyrtari për RDPP ka pranuar gjithsejtë **657** kërkesa nga palë të ndryshme për realizimin e të drejtave ligjore që dalin nga Regjistrimi i të Drejtave në Pronën e Paluajtshme (RDPP).

Nga të gjitha këto kërkesa deri me tani janë shqyrtuar **629** dhe për të njëjtat janë lëshuar aktvendime adekuate, ndërsa **28** kërkesa janë në procedurë e sipër.

I njëjti ka lëshuar **405** aktvendime për azhurnimin e lëndëve të terreni.

Aktvendimet me të cilat palës i është njohtë e drejta në RDPP, në afat ligjor dërgohen te referenti për ndryshime kadastrale i cili kon

form këtyre vendimeve bënë azhurnimin në librat përkatës të elaboratit kadastral dhe të njëjta prapë i azhurno duke i fut të dhënat në kompjuter përkatësisht në programin e SIKTK-së

Nga zyrtarët e mirëmbajtjes së kadastrit, gjatë vitit 2022 kanë ber azhurnimin e **413** lëndëve nga terreni sipas kërkesë së palëve siç janë : Ndarja e parcelave, bashkimi i parcelave, regjistrimi i objekteve, korrigjimi i sipërfaqeve, korrigjimi i mexhave dhe futja e të dhënave të reja në sistem

etje. Këto lëndë të gjitha janë zgjedhur me përjashtim të **12** rasteve të cilat ende janë në procedurë e sipër. Gjithashtu këta zyrtar gjatë kësaj periudhe kanë lëshuar **12** historiata dhe identifikime të mexhave sipas kërkesave të palëve dhe kanë lëshuar **550** kopje plani.

Nga referenti për pranimin e palëve gjatë kësaj periudhe ka pranuar gjithsejtë **1287** kërkesa të cilat kryesisht kanë të bëjnë me dhënien e certifikatave të pronës së paluajtshme, kopjeve të planit si dhe një sere detyrash tjera.

Marrë në përgjithësi numri i kërkesave dhe shtimi i volumit të punëve karshi qytetarëve është dukshëm më i madhe se ne vitet paraprake.

Vlen te ceket se gjatë vitit 2022 në kuadër të fushatës për njohje më të mirë të drejtave tek te dy bashkëshortet në komunën e Deçanit si pasuri të përbashkët kanë regjistruar 104 persona që vërehet dukshëm rritja e interesimit dhe vetëdijesimi i qytetarëve.

Tash e sa kohë në këtë dikaster i cili është i vendosur në Pallatin e Kulturës „Jusuf Gërvalla” kati II-të , janë krijuar edhe kushtet e volitshme për punë , staf i mjaftueshme në kryerjen e detyrave dhe rezultatet nuk mungojnë.



